



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 7.6.2023

Nr: 660

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor me vendimin nr. 528, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Mallakastër. Kundër këtij vendimi është administruar kërkesa ankimore nr. 78, datë 22.5.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me objekt: “Kundërshtimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin bashkiak, në KZAZ nr. 62, Mallakastër.

Më datë 30.5.2023, ora 15:00, në seancë publike KAS shqyrtoi kërkesën ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 78, datë 22.5.2023.
2. Korrigjimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin bashkiak, KZAZ nr. 62, Bashkia Mallakastër, sipas gjetjeve të konstatuara nga KAS, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe nenit 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Mallakastër pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim:

(Tabela nr. 1)

| Nr. FV | Subjekti Zgjedhor | Vota | Përqindja |
|--------|--|--------------|--------------|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 864 | 7,01 % |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 4212 | 34,20 % |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 513 | 4,16 % |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 448 | 3,64 % |
| 5 | Partia Lëvizja e Legalitetit | 564 | 4,58 % |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | 748 | 6,07 % |
| 7 | Aleanca Liberale e Djathtë | 812 | 6,59 % |
| 8 | Partia Socialdemokrate | 643 | 5,22 % |
| 9 | Partia Demokratike | 1430 | 11,61 % |
| 10 | Aleanca Progresiste L.ZH.K | 109 | 0,88 % |
| 11 | Fryma e Re Demokratike | 80 | 0,65 % |
| 12 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 914 | 7,42 % |
| 14 | Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë | 408 | 3,31 % |
| 22 | Partia Unitetit Kombëtar | 358 | 2,91 % |
| 32 | Partia Komuniste e Shqipërisë | 214 | 1,74 % |
| | Totali | 12317 | 100 % |

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 21 (njëzetë e një) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Mallakastër, në bazë të shkresës me nr. 115 prot., datë 30.1.2023, të Prefektit të Qarkut Fier.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 21 (njëzetë e një). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim:

(Tabela nr. 3)

| Nr. | Herësi | Subjekti |
|-----|--------|--------------------------------|
| 1 | 4212 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 2 | 2106 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 3 | 1430 | Partia Demokratike |
| 4 | 1404 | Partia Socialiste e Shqipërisë |

Data: 7.6.2023 Nr. 660
Ora: 11:30



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e Bashkisë Mallakastër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

| | | |
|----|------|--|
| 5 | 1053 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 6 | 914 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet |
| 7 | 864 | Bashkë Fitojmë |
| 8 | 842 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 9 | 812 | Aleanca Liberale e Djathtë |
| 10 | 748 | Partia Demokracia Sociale |
| 11 | 715 | Partia Demokratike |
| 12 | 702 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 13 | 643 | Partia Socialdemokrate |
| 14 | 601 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 15 | 564 | Partia Lëvizja e Legalitetit |
| 16 | 526 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 17 | 513 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë |
| 18 | 476 | Partia Demokratike |
| 19 | 468 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 20 | 457 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet |
| 21 | 448 | Partia Republikane Shqiptare |

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim:

(Tabela nr. 4)

| Nr. | Subjekti Zgjedhor | Mandate |
|------------|--|----------------|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 1 |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 9 |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 1 |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| 5 | Partia Lëvizja e Legalitetit | 1 |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | 1 |
| 7 | Aleanca Liberale e Djathtë | 1 |
| 8 | Partia Socialdemokrate | 1 |
| 9 | Partia Demokratike | 3 |
| 10 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 2 |

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllëgarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të

miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Mallakastër, si më poshtë:

| Subjekti Zgjedhor | Mandate |
|--|----------------|
| Bashkë Fitojmë | 1 |
| Partia Socialiste e Shqipërisë | 9 |
| Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë | 1 |
| Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| Partia Lëvizja e Legalitetit | 1 |
| Partia Demokracia Sociale | 1 |
| Aleanca Liberale e Djathtë | 1 |
| Partia Socialdemokrate | 1 |
| Partia Demokratike | 3 |
| Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | 2 |

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëpartore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1. Sabire Yzedin Hoxhaj

Partia Socialiste e Shqipërisë

1. Nexhmi Gani Sulaj
2. Lindita Jashar Ymeraj
3. Armando Ylli Hasanbashaj
4. Marinela Pëllumb Rrapaj
5. Klodjan Vladimir Shehaj
6. Enkeleda Resmi Hyskaj

7. Bejkush Qamil Haxhiaj
8. Anajada Mynyr Çilotaj
9. Ledjon Fatmir Salaj



Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë

1. Xhafer Novrus Osmënaj

Partia Republikane Shqiptare

1. Adrian Sabri Hazizaj

Partia Lëvizja e Legalitetit

1. Përparim Ylmi Bengaj

Partia Demokracia Sociale

1. Kliton Festim Aliaj

Aleanca Liberale e Djathtë

1. Oldison Kastriot Caushaj

Partia Socialdemokrate

1. Ermal Tetem Hasimaj

Partia Demokratike

1. Suzana Petrit Malaj

2. Lefter Qani Rabi

3. Pajtime Zylyftar Liçaj

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

1. Armelin Agur Agaj

2. Giola Klement Lutaj

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Bashkia Mallakastër, herësit

Tabela nr. 2

| NR_FV | SUBJEKTI | SIGLA | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | |
|-------|--|---------|------|------|------|------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|---------------------------------|
| 1 | Bashkë Fitojmë | BF | 864 | 432 | 288 | 216 | 172 | 144 | 123 | 108 | 96 | 86 | 78 | 72 | H e r ë s i t |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PS | 4212 | 2106 | 1404 | 1053 | 842 | 702 | 601 | 526 | 468 | 421 | 382 | 351 | |
| 3 | Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë | P.A.A | 513 | 256 | 171 | 128 | 102 | 85 | 73 | 64 | 57 | 51 | 46 | 42 | |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | PR | 448 | 224 | 149 | 112 | 89 | 74 | 64 | 56 | 49 | 44 | 40 | 37 | |
| 5 | Partia Levizja e Legalitetit | PLL | 564 | 282 | 188 | 141 | 112 | 94 | 80 | 70 | 62 | 56 | 51 | 47 | |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | P.D.S | 748 | 374 | 249 | 187 | 149 | 124 | 106 | 93 | 83 | 74 | 68 | 62 | |
| 7 | Aleanca Liberale e Djathtë | ALD | 812 | 406 | 270 | 203 | 162 | 135 | 116 | 101 | 90 | 81 | 73 | 67 | |
| 8 | Partia Socialdemokrate | PSD | 643 | 321 | 214 | 160 | 128 | 107 | 91 | 80 | 71 | 64 | 58 | 53 | |
| 9 | Partia Demokratike | PDSH | 1430 | 715 | 476 | 357 | 286 | 238 | 204 | 178 | 158 | 143 | 130 | 119 | |
| 10 | Aleanca Progresiste L.ZH.K | LZHK | 109 | 54 | 36 | 27 | 21 | 18 | 15 | 13 | 12 | 10 | 9 | 9 | |
| 11 | Fryma e Re Demokratike | FRD | 80 | 40 | 26 | 20 | 16 | 13 | 11 | 10 | 8 | 8 | 7 | 6 | |
| 12 | Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet | P.D.I.U | 914 | 457 | 304 | 228 | 182 | 152 | 130 | 114 | 101 | 91 | 83 | 76 | |
| 14 | Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë | AD | 408 | 204 | 136 | 102 | 81 | 68 | 58 | 51 | 45 | 40 | 37 | 34 | |
| 22 | Partia Unitetit Kombetar | PUK | 358 | 179 | 119 | 89 | 71 | 59 | 51 | 44 | 39 | 35 | 32 | 29 | |
| 32 | Partia Komuniste e Shqipërisë | PKSH | 214 | 107 | 71 | 53 | 42 | 35 | 30 | 26 | 23 | 21 | 19 | 17 | |